

16.08.2017.
Hoxha



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS
Udhëzimi për dërgim të dokumenteve të Kulturës dhe Sportit Kërkime të Trashëgimisë Kulturore Prizren
Nr. 210/4
Datë 16.08.2017

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATË/A:	14.08.2017
REFERENC-Ë:	210/4
PËR/ZA/TO:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
GA/OD/FROM:	Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rekomandimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë

Po ju dërgojmë Rekomandimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturore nr. 16/2017 të dt.20.07.2017 për lëndën e Vahid Fetahi Nr.04-3533/01-59982.

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Rekomandimit.

2. Vahid Fetahi nga Prizreni ka parashtruar kërkesë për ndërtimin e objektit – shtëpi individuale e banimit me etazhitet B+P+1 në parcelën me Nr. 3530 – 0 dhe 3531 – 0. Kjo parcelë gjendet në zonën e VI të Nënkalasë, ku sipas Planit të Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit, etazhiteti i lejuar është P+1 si dhe lartësia deri te streha është 6.5m dhe për ndërtim mund të shfrytëzohet deri 50% e sipërfaqes së parcelës. Parcela për ndërtim gjendet afër këtyre objekteve: Kisha e Shën Spasit, Kisha e Shën Dielës dhe Kalaja e Prizrenit, që të gjitha janë në listën e MKRS – së (Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme). Po ashtu vlen të theksohet se në parcelat për të cilën bëhet fjalë, ndërtimi i ri, nuk ka ndërtesë ekzistuese. Projekti parashih bashkimin e dy parcelave të vogla, sipërfaqja e të cilave pasi që të bashkohen nuk e arrin as 100 m².

Shënim: Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit nuk lejon bashkim të parcelave, për shkak që të mos ndërtohen ndërtesa me vëllime më të mëdha se ato ekzistuese, mirëpo në këtë rast nëse nuk bashkohen këto dy parcela, pronari nuk mund ta shfrytëzojë asnjërin për ndërtim për shkak të dimensioneve shumë të vogla, ku totali i tyre është nën 100 m².

Projekti i paraparë për ndërtim sipas projektit ideor është i një arkitekture tradicionale si dhe materialet e përdorura janë në harmoni me materialet e lejuara për atë zonë të ndërtimit. Gjatë shqyrtimit Komisioni vërejtë se pala nuk i ka respektuar parametrat e Planit të Konservimit sa i përket vendosjes në terren të pjerrët dhe respektimit të nivelit 0.

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës,

Rekomandon:

1. Të refuzohet Projekti ideor i palës Vahid Fetahi, për ndërtimin e objektit – shtëpi individuale e banimit me etazhitet B+P+1 në parcelat me nr. 3530-0 dhe 3531-0, në Zonën IV të Qendrës Historike të Prizrenit, pasi që pala nuk i ka respektuar parametrat në lidhje me vendosjen e ndërtesës në terren dhe respektimin e lartësisë 6.5 m deri te streha e ndërtesës, ashtu siç përcaktohet në Planin e Konservimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit, Zona IV.
2. Rekomandohet pala që gjatë përpilimit të projektit ideor tjetër t'i përmbahet parametrave të lartësisë (max.h =6.5m).
3. Pika me e ulët e terrenit të pjerrët që pritet me gabaritin e ndërtesës të jetë pika zero e ndërtesës.